

# KONTROLLI I LARTE I SHTETIT

## KRYETARI

Nr. \_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2018

### V E N D I M

**Nr. 150, Datë 29.09.2018**

**PËR  
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË  
DREJTORINE RAJONALE TË MJEDISIT PYJEVE DHE UJËRAVE NË  
QARKUT SHKODËR" MBI ZBATIMIN E RREGULLSHMËRISË DHE  
PËRPUTHSHMËRISË" për periudhën 01.01.2016 deri me 30.06.2018.**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projekt vendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrolli i Zbatimit, Sigurimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, në mbështetje të neneve 10, 15 dhe 30, të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

### V E N D O S A:

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "*Për auditimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë, për procedurën e pranimin dhe administrimit të dokumentacionit për vlerësimin dhe evidentimin e trajtimit ligjor të tyre*", të ushtruar në Drejtorine Rajonale të Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve Shkoder, sipas programit të auditimit nr.727/1 date 26.06.2018, për periudhën nga data 01.01.2016 deri me datë 30.06.2018.

**II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

### **A .MASA ORGANIZATIVE**

1. **Gjetje nga auditimi:** DR ISHMPU nuk ka krijuar dosje të përhershme të inspektimit për çdo subjekt të inspektuar në kundërshtim me Urdhrin e Inspektoratit Qendror nr.13 datë 23.04.2015 "Për miratimin e manualit të përgjithshëm të Inspektimit në Republikën e Shqipërisë. Sektori i Inspektimit Pyjeve në Qarkun e Shkodër nuk ka një bazë të dhënash të saktë dhe të listuar sipas subjekteteve ne ekonomite pyjore të cilat operojnë në Qarkun e Shkodrës, " në kundërshtim me Urdhrin e Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit nr.4 datë 19.02.2015 "Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut. Nuk disponohen kopjet e hartave të ekonomive pyjore, planet e mbarështimit dhe të inventarizimit, hartat e zonave të mbrojtura, ndarjet e pronësisë së fondit pyjor e kullësor, planet e menaxhimit të pyjeve komunale dhe private (*Trajtuar në faqen 15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1.Rekomandim:** DR ISHMPU Shkoder të marrë masa për krijimin e rregjistrave të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në ekonominë pyjore, si dhe krijimin e dosjeve për çdo subjekt objekt inspektimi për sektorin e mjedisit dhe në sektorin e pyjeve, të sigurojë dokumentacionin tekniko-ligjor për këto subjekte, duke përfshirë dhe planet e mbarështrimit dhe menaxhimit të pyjeve komunale dhe private.

### *Menjëherë*

**2.Gjetje nga auditimi:** Sektori i Inspektimit mjedisor në DR ISHMPU Shkodër, nuk ka një bazë të dhënash të saktë dhe të listuara sipas ndikimeve që kanë në mjedis subjektet të cilat operojnë në Qarkun e Shkodrës, mbështetur në këto të dhëna të bëhej identifikimi i subjekteve dhe veçimi i atyre me risk të lartë e ndikim në mjedis. Kjo në përmbushje të detyrimeve ligjore si dhe detyrimeve që rrjedhin nga Urdhrat e Inspektoratit Qendror nr.13, datë 23.04.2015 "*Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë*" dhe nr.4 datë 19.02.2015 "*Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut*".

DR ISHMPU në planifikimet vjetore e mujore si dhe në inspektimet e kryera, nuk ka përfshirë një masë të konsiderueshme të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në Qarkun e Shkodrës të publikuar nga Bashkia Shkodër si aktivitete me ndikim në mjedis. Nga 86 subjekte me aktivitet me ndikim në mjedis nga DR ISHMPU Shkodër janë mbuluar me inspektim gjatë periudhës objekt auditimi vetëm 19 subjekte dhe janë lënë jashtë planifikimit vjetor 63 subjekte në kundërshtim me ligjin nr.10431 datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" seksioni 2, neni 62-66 "Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit" (*Trajtuar në faqen 15-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1.Rekomandim:** DR ISHMP Shkodër nëpërmjet sektorit të mjedisit të marrë masa që programet vjetore dhe mujore të inspektimit të hartohen në bazë rrisht, ku të përcaktohet në detaje inspektimi, duke u nisur nga informacioni paraprak për të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitetet në Qarkun e Shkodrës dhe përqëndrimi në ato aktivitete që kanë mundësi ndikimi në mjedis, duke parashikuar një gamë më të gjërë subjektësh, jo vetëm ato të raportuara me leje mjedisore nga DRM Shkodër për kryerjen e inspektimeve mbi bazën e bashkëpunimit me institucionet si; Drejtoria Rajonale e Tatimeve të Qarkut Shkodër, QKB, Bashki e Njësi Administrative dhe institucione të tjera.

### *Vazhdimisht*

**3. Gjetje nga auditimi:** Në 32 raste në procesverbalet e hartuara nga inspektorët në proceset e inspektimit u paraqiten parregullsi dhe konstatime për mosplotësim të kushteve të lejeve, pasi nuk përcaktohen se cilat kushte nuk janë realizuar sipas emërimit të pikave të lejes. Në inspektimet e kryera si ato fillestare dhe ato verifikuese, inspektorët janë kontradiktorë në konstatimet e tyre në përcaktimin e llojit të aktivitetit. Gjithashtu, në shumë raste është lënë si detyrë plotësimi i kushteve të lejes ose rishikim i kushteve të lejes, pa përcaktuar se për çfarë kushtesh bëhet fjalë. Ka raste kur subjektit i është lënë detyrë të plotësohet "dokumentacioni mjedisor" dhe nuk përcaktohet se cilat dokumenta mungojnë. Në disa raste është kërkuar në formë të përgjithshme plotësimi i kushteve të lejes, pa u shprehur në gjithë përshkrimin e procesverbalit të inspektimit nëse janë shkelur ndonjë kusht i lejes dhe pa përcaktuar se cilat janë ato. Gjithashtu, në këto dokumente konfirmohet vetëm që subjekti ka plotësuar raportin e monitorimit periodik, ndërsa në ri-inspektim inspektorët shprehin vetëm për plotësimin e vetmonitorimit dhe jo për kushtet e lëna si detyrë në inspektimin paraardhës. Këto mangësi dhe pasaktësi të konstatuara në kryerjen e inspektimeve, janë në kundërshtim me ligjin nr.10431 datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" seksioni 2 neni 62-66 "Inspektimi për mbrojtjen e mjedisit" dhe me ligjin nr.10433 datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" nenin 45-48 (*Trajtuar në faqen 18-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1.Rekomandim:** Sektorin e mjedisit në DR ISHMPU Shkodër të marrë masa, që në procesin e inspektimit përshkrimi konstatimeve në procesverbalet e inspektimit të bëhet në mënyrë të saktë, pasi të jenë verifikuar në mënyrë të plotë informacioni i marrë nga subjekti në formë dokumentare dhe verifikimi në terren i veprimtarisë në drejtim të zbatimit të kushteve të lejes, si dhe të bëhet referimi i saktë dhe i plotë i dispozitës ligjore për moszbatimin apo jo të të lejes së mjedisit dhe në

rastet e mosplotësimit të kushteve të përcaktuara të shprehen qartë për detyrat e lëna në mënyrë që të momentin e ri-inspektimit të jenë lehtësisht të verifikueshme për zbatim.

*Vazhdimisht*

**4. Gjetje nga auditimi:** Në të gjitha procedurat e trajtuara më sipër të përzgjedhura për auditim rezultoi se, grupet e inspektimit në terren nuk janë shprehur në lidhje me kontrollin e dokumentacionit tekniko-ligjor për ushtrimin e aktivitetit dhe të dhënat tjera që kanë të bëjnë me kushtet e lejes siç janë shkarkimet në ajër, tokë dhe ujë si dhe planin e menaxhimit të mbetjeve, pa bërë krahasime të tyre me verifikimet në terren, duke kryer vetëm një verifikim të thjeshtë për lëshimin e lejes mjedisore dhe pagesat vjetore të tarifave mjedisore, si dhe të paraqitjes thjeshtë të dokumentit të vetmonitorimit pa vërtetuar nëse treguesit e saj janë real apo jo në aspektin e përgjithshëm. Në këto raste proces-verbalet mbeten formale, gjë që i bën misionet e inspektimit: jo eficientë, jofunksionale, të paplota, në mospërputhje me nenin 45, të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, nenit 65, të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për lejet e mjedisit”, nenit 14 “Vlerat 26 kufi të shkarkimeve”, neni 44 “Monitorimi i përputhshmërisë” sipas shtojcës “2”, bashkëlidhur ligjit, “Lista indikativë e substancave kryesore ndotëse që duhen marrë parasysh në qoftë se kanë rëndësi për caktimin e vlerave kufi të shkarkimeve” të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, me nenin 19 “Vetëmonitorimi” (*Trajtuar në faqen 18-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4.1.Rekomandim:** Sektori i inspektimit të mjedisit në DR ISHMPU në procedurat e inspektimit, krahas kontrollit të zbatimit të kushteve të lejeve dhe dokumentacionit tekniko-ligjor të mjedisit duhet të përqëndrohet edhe në verifikimin në terren të normave cilësisë së mjedisit për ndotës apo grupe të veçanta ndotësish krahasuar me rezultatet e vetmonitorimit për të siguruar përputhshmërinë me kushtet e lejes dhe legjislacionin përkatës.

*Vazhdimisht*

**5. Gjetje nga auditimi:** Në 4 raste nga grupet e inspektimit është lënë si detyrë rehabilitimi e zonës nga subjektet private ku kanë ushtruar aktivitetin, por nuk janë shprehur se çfarë është dëmtuar, sasia e sipërfaqes së dëmtuar dhe afatin periodik të rehabilitimit sipas VNM dhe lejes së tipit B. Nuk është ushtruar rishikim apo ri-inspektim për të verifikuar nëse është realizuar rehabilitimi i zonës së dëmtuar nga pikpamja mjedisore dhe në rast të kundërt të kërkohej përlllogaritja në vlerë e dëmtimit në bazë të sipërfaqes dhe kthimi i tij si dhe vendosjes së dënimit me gjobë për mos kryerje të këtij kushti të lejes në kundërshtim me ligjin nr.10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” Kreu VIII “Përgjegjësia mjedisore” neni 50 pika 1/a,b neni 52”Kompensimi i dëmit në mjedis” neni 52 Kreu XI neni 62 “Inspektimi për mbrojtjen e mjedisit” pika(dh) e cila përcakton: *dh) siguron zbatimin e parimit të përgjegjësive mjedisore, në përputhje me dispozitat e këtij ligji*” neni 69 “Kundravajtjet” pika (dh) (*Trajtuar në faqen 29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**5.1.Rekomandim:**DR ISHMPU nëpërmjet Kryeinspektorit dhe sektorit të inspektimit të mjedisit, të marrë masa për kryerjen e ri-inspektimit në **4 raste:** Subjekti “Energji Univers” shpk me aktivitet “HEC”; Subjekti “Beton Plus” Shpk me aktivitet “Karjer për shfrytëzim inertesh”; Subjekti “Sabina” Shpk me aktivitet: “Disiplinim i shtratit të lumit Drin” dhe subjekti “Stone-Alb” me aktivitet “Gurore”, për të verifikuar nëse është realizuar rehabilitimi i zonës së dëmtuar nga pikpamja mjedisore dhe në rast të kundërt të kërkohej përlllogaritja në vlerë e dëmtimit në bazë të sipërfaqes dhe kthimi i tij në gjendjen fillestare, si dhe vendosjes së dënimit me gjobë për mos kryerje të këtij kushti të lejes.

*Brenda muajit dhjetor të vitit 2018*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga të dhënat dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion në Qarkun Shkodër 15 subjekte kanë ushtruar aktivitet “gurore”, për të cilat nuk ka të dhëna nëse ushtrojnë aktivitet aktualisht, megjithëse ato figurojnë me status aktiv sipas QKB.

Nuk është bërë një verifikim në terren dhe nuk është programuar një inspektim i tyre, për të konstatuar dhe evidentuar situatën e gjendjes së mjedisit, ekzaminimin e dëmtimeve në mjedis të shkaktuar nga aktiviteti i tyre.

Nuk ka një vlerësim të shkallës së ndikimit në mjedis në terrenet ku është shtrirë aktiviteti i tyre, si dhe nuk është bërë përcaktimi i vlerës së dëmit e nxjerrjen e përgjegjësisë, të cilat duhet të ishin pjesë e raportimeve në institucionet përgjegjëse të Ministrisë së Mjedisit në kundërshtim me ligjin nr.10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” Kreu VIII “Përgjegjësia mjedisore” neni 50 pika 1/a,b neni 52”Kompensimi i dëmit në mjedis” neni 52 Kreu XI neni 62 “Inspektimi për mbrojtjen e mjedisit”pika(dh), neni 69 “Kundravajtjet” (*Trajtuar në faqen 30-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**6.1.Rekomandim:** DR ISHMPU Shkodër të marrë masa për programimin dhe kryerjen e inspektimeve në **15 rastet** e listuar në tabelën e paraqitur në faqen 24 të Raportit Përfundimtar të auditimit, pasi të ketë marrë informacion për aktivitetin e tyre. Të bëjë verifikimet në terren të krahasuara këto me dokumentacionin ligjor të tyre si dhe të ushtrojë kompetencat për vendosje gjobë për kundravajtjet e kryera në lidhje me dëmtimet e shkaktuara në mjedis në këto zona dhe për kërkimin e arkëtimit të detyrimit me të gjitha procedurat administrative e ligjore për rehabilitimin sipërfaqeve të zonave të dëmtuara.

*Brenda muajit Dhjetor 2018*

**7. Gjetje nga auditimi:** DR ISHMPU Shkodër nuk ka bërë evidentimin e plotë dhe të saktë të subjekteve fizik/juridik që ushtrojnë aktivitet të llojeve te ndryshme në fondin pyjor kullësor pjese te cilave jane dhe monumentet natyrore dhe zonat e mbrojtura të cilat kryejnë veprimtari të ndryshme me karakter ekonomik dhe social si: *gjuetia, përpunim-tregtim të produkteve me origjinë pyllin, (drusore ose jo drusore), bujqësia tradicionale, agro-pylltaria dhe të gjitha aktivitetet artizanale, kulturore, sportive dhe shërbimet turistike.*

Nuk ka të dhëna për to në lidhje me aktivitetet e tyre (licencimi, koha e ushtrimit të aktivitetin, lejet mjedisore, territoret apo dhe veprimtaritë e të cilëve përfshihen në zonën e mbrojtur ose në atë buferike) në kundërshtim ligjit nr.9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”si dhe të shkresës të ISHMPU Tiranë nr.207, datë 23.05.2014 “Për evidentimin e subjekteve te cilat ushtrojnë aktivitet në fondin pyjor kullësor e te gjuetisë deh subjekteve grumbulluese, perpunuese e treguese te produkteve me origjinë pyllin dhe lendet drusore”,me ligjin nr. 8906, date 06.06.2002 “Per Zonat e Mbrojtura” i ndryshuar, nenin 9 pika 5 (*Trajtuar në faqen 32-34 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**7.1.Rekomandim:** DR ISHMPU Shkodër në bashkëpunim me Inspektoriatin Qendror dhe AKZM Tiranë të marrë masa, për bashkëpunimin me Drejtorinë e Tatimeve Shkodër dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, për sigurimin e të dhënave për subjektet që ushtrojnë aktivitet në fondin pyjor-kullësor e vecanërisht në Zonat e Mbrojtura, në mënyrë që të identifikohen subjektet të palicënuara dhe të pa pajisura me leje mjedisore për ushtrimin e veprimtarisë në këto zona, për të cilat të organizohen inspektime dhe nëse janë të paligjshme të ushtrohet kompetenca për dënimin administrativ apo pezullimin e tyre.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

**8.Gjetje nga auditimi:**Në **6 raste** të inspektimit në ekonomitë pyjore në procesverbalet e mbajtura ka konstatime shkeljesh ligjore si ne drejtim të rregullave që duhet të zbatohen në ushtrimin e aktivitetit për eliminimin e ndikimit në mjedis, për të cilat nuk ka ri-inspektim të detyrave të lëna, në drejtim të prerjes së lëndës drusore në të cilat nuk është gjetur autori dhe pa dënim të përgjegjësve të ruajtjes së zonës. Në ndonjë rast procesverbali është përshkruar i kushteve natyrore dhe mungesës së mjeteve për pamundësinë e kryerjes së e inspektimit, duke dalë jashtë qëllimit të inspektimit. Kundravajtjet janë konstatuar në parcelat e fondit pyjor, pronë e bashkive përkatëse, të cilat pavarësisht se kanë ngritur strukturat e tyre, ato janë joeficente, duke mos i dhënë rëndësi administrimit dhe ruajtjes së fondit pyjor-kullësor, vërehet mungesë përgjegjësie nga ana e tyre, pikërisht nga ndodhja e fenomenit dhe mosparandalimit i prerjeve të lëndës drusore. Për këto DR ISHMPU Shkodër duhet të jepte dënim edhe ndaj këtyre institucioneve, në mënyrë që ata të ndërgjegjësohen dhe ti japin rëndësinë e duhur për eliminimin e dëmtimeve në fondin-pyjor-kullësor, pronë e tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin 10433 “Për Inspektimin në Republikën e

Shqipërisë” datë 16.06.2011 ne Kreu II ,neni 45 pika 5,6 (*Trajtuar në faqen 34-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**8.1.Rekomandim:** DR ISHMPU Shkodër të marrë masa që për rastet e konstatimeve të dëmtimeve të parcelave pyjore-kullosore, pronë e Bashkive përkatëse, që të ushtrijë kompetencën e saj për dënimin administrativ edhe të këtyre NJQV, të cilat kanë për detyrë ruajtjen dhe administrimin me efektivitet të fondit pyjor-kullosor, me qëllim parandalimin e dëmtimeve të këtyre resurseve dhe vënien para përgjegjësisë pronarët e tyre.

### *Menjëherë dhe në vazhdimësi*

**9. Gjetje nga auditimi:** Në 3 raste janë marrë vendime administrative me masën “gjobë” në mungesë të: autorizimit të miratuar nga Kryeinspektori, procesverbalit të inspektimit me kundravajtjet e konstatuara, si dhe të aktit të sekuestrimit nëse ka patur mall të kapur në kushte të kundraligjshme, veprime e mosveprime këto në kundërshtim me ligjin nr.10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” Kreu IV “Rregulla të përgjithshme për programimin dhe autorizimet e inspektimit” neni 20-29 Kreu V “procedura e inspektimit neni 30-44, Kreu VI “procesverbali i inspektimit dhe vendimi përfundimtar”, neni 46-48 (*Trajtuar në faqen 35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**9.1. Rekomandim:** DR ISHMPU të marrë masa që inspektorët të zbatojnë rregullat e procesit të inspektimit duke filluar që në marrjen nga ana e tyre të autorizimit të miratuar nga kryeinspektori, mbajtjes dhe plotësimit në mënyrë të hollësishme dhe të saktë të konstatimeve referuar dispozitave ligjore. Në rastet e e bllokimit të lëndëve drusore dhe mjeteve transportuese të tyre të kundraligjshme, procesverbalet të shoqërohen me aktin e sekuestrimit të kofirmuar nga mrrësi në dorëzim. Mbi bazën e tyre të gjykojnë dhe të shqyrtojnë kundravajtjet dhe përcaktimin e masës administrative për to duke I finalizuar me vendim administrativ.

### *Vazhdimisht*

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga të dhënat e faqes së licencimit të ish-Ministrisë së Energjetikës dhe Industrisë të paraqitura në Eëb në Qarkun Shkodër, janë 30 subjekte që kryejnë aktivitetet të shtrira në Fondin Pyjor-kullosor për “ nxjerrje guri, gur geleror, argjile dhe zhavorr” dhe “nxjerrje mineralesh të ndryshme”. Ne keto tre Bashkie të ndara si: 10 subjekte kryejnë aktivitetin në territorin nën juridiksionin e bashkisë Shkodër-Vau Dejës, 17 subjekte në territorin nën juridiksionin bashkisë Pukë dhe 3 subjekte shtrijnë aktivitetin në territorin nën juridiksionin bashkisë Malësi e Madhe. Për këto subjekte, nuk është bërë një verifikim në terren dhe nuk është programuar një inspektim i tyre, për të konstatuar dhe evidentuar situatën e gjendjes së mjedisit, ekzaminimin e dëmtimeve në mjedis të shkaktuar nga aktiviteti i tyre. Nuk disponohen kontrata dhe të dhëna të tjera tekniko-ligjore, mbi bazën e të cilave duhej të bëhej një vlerësim i shkallës së ndikimit në mjedis në terrenet pyjore e kullosore, ku është shtrirë aktiviteti i tyre, si dhe të bëhej përcaktimi i vlerës së dëmit dhe kërkimin e rehabilitimit të këtyre parcelave në përputhje me planet e mbarështrimit të pyjeve të NJVQV-ve, ose të bëhej dënimi me masë administrative “gjobë” dhe kërkohet pagesa e vlerës së dëmit. Nuk ka të dhëna nëse për këto raste, parcelat e shfrytëzimit nga këto subjekte janë hequr apo jo nga fondi pyjor. Në rastet e heqjes nga fondi pyjor të bëhej kërkimi i pagesës së përcaktuar për të. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr.391 datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” i ndryshuar me VKM nr.1064 datë 22.12.2010 pika 8, lidhja 8 “Tarifat e shpërbllimit të dëmeve të shkaktuara në fondin pyjor”pika 15. Gjithashtu mosndjekja e këtyre procedurave për këto subjekte nga ISHMPU Shkodër është në kundërshtim me ligjin nr.10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Kreu VIII “Përgjegjësia mjedisore”, neni 50 pika 1/a,b, neni 52”Kompensimi i dëmit në mjedis”, Kreu XI, neni 62“Inspektimi për mbrojtjen e mjedisit”pika(dh) dhe neni 69 “Kundravajtjet” (*Trajtuar në faqen 37-39të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**10.1.Rekomandim:** DR ISHMPU Shkodër të marrë masa për të programuar dhe kryerjen e inspektimit të 30 subjekteve të listuara sipas tabelave të paraqitura në faqen 32-33 të raportit përfundimtar të auditimit, pasi të marrë të dhëna DRTT Shkodër për statusin e tyre e të mundësojë

disponimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të tyre dhe në rastet e konstatimit të shkeljeve ligjore dhe detyrimeve kontraktore të ushtrjës kompetencën e saj për dënimin me gjobë për kundravajtjet e kryera në lidhje me dëmtimet e shkaktuara në mjedis në rastet e mosrehabilitimit në këto zona dhe për kërkimin e detyrimit me të gjitha procedurat administrative e ligjore për rehabilitimin sipërfaqeve të zonave të dëmtuara, në të kundërt kërkimin e vlerës së dëmit.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga analiza e fondeve të alokuara nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe të përdorura nga DR ISHMPU Shkodër, rezulton se fondet janë të pamjaftueshme për realizimin e funksioneve të këtij institucioni, pasi ka mungesa investimesh për paisje zyrash dhe automjete për lëvizjen e specialistëve për kryerjen e inspektimeve në subjekte dhe zona me shtrirje të madhe territoriale dhe terrene të vështira. Gjithashtu mungojnë fonde për shpenzime operative, për blerje karburanti, shpenzime për udhëtim e dieta për lëvizje të specialistëve në territoret që kanë në kompetence për ushtrimin e verifikimeve të nevojshme për subjektet e pajisura me leje mjedisore. Mungojnë edhe shpenzime të tjera plotësuese si për larje fotosh, për blerje kancelarish për përgatitjen e dokumenteve evidentuese, të cilat janë të domosdoshme si pjesë e procedurave të inspektimit (*Trajtuar në faqen 37-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**11.1.Rekomandimi:** DR ISHMPU Shkodër të kërkojë nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, mundësinë e mbështetjes së punës së tyre inspektuese me rritje të buxhetit, për të përballuar nevojat bazë dhe krijimin e kushteve të domosdoshme për realizimin e funksioneve të këtij institucioni dhe detyrave nga inspektorët.

*Menjëherë e në vijimësi*

## **B. TË ARDHURA TË MUNGUARA**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të inspektimit rezultoi se 20 subjekte janë **të pa pajisura me leje** mjedisore. Nga DR ISHMPU Shkodër nuk është realizuar inspektimi i verifikimit të realizimit të detyrës së lënë për nxjerrjen nga këto subjekte private të lejes së mjedisit. Gjithashtu për këto subjekte nuk është marrë vendim administrativ “dënim me gjobë” për shkeljet e konstatuara në kundërshtim me ligjin nr.10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” seksioni 2 neni 62-66 “Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit”, me ligjin nr.10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” nenin 45-48 dhe me ligjin nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, **neni 29, pika 1/ii, “Kundërvajtjet”,** i cili përcakton se: “*pa lejen përkatëse të mjedisit të tipit B, subjektet dënohen me gjobë në vlerën nga 500,000 deri në 1,000,000 lekë*”. Grupi i inspektimit nuk ka marrë vendimin për dënim administrativ **“gjobë” në masën 300,000 lekë për 23 rastet** e subjekteve me aktivitet që i përkasin lejeve të mjedisit tipi C, **duke shkatuar të ardhura të munguara në vlerën 6,900,000 lekë** (*Trajtuar në faqen 18-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1.Rekomandimi:** DR ISHMPU Shkodër të marrë masa për të programuar 20 subjektet të listuara në tabelën e paraqitur në faqen 14-15 të Raportit Përfundimtar të auditimit dhe nese vazhdojnë të kryejnë aktivitetin e tyre ,të merrem masa administrative dënim me gjobë për shkeljet ligjore.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të inspektimit rezultoi se 4 subjekte **janë në proces** për tu pajisur me leje mjedisore. DR ISHMPU Shkodër ka ushtruar inspektime për verifikimin e detyrës së lënë për nxjerrjen nga këto subjekte private të lejes së mjedisit. Në këto subjekte, ka rezultuar se kanë filluar procedurat e licencimit mjedisor, por nuk është proceduar për rishikim në periudha të mëvonshme nëse këto subjekte janë pajisur përfundimisht me leje mjedisore. Mungesa e ri-inspektimeve ka sjellë mosverifikimin deri në pajisjen me leje mjedisore të subjekteve në proces licencimi dhe mosevidentimin e rasteve të refuzimeve, të cilat përbëjnë objekt dënim me gjobë për kundravajtje në shumën nga 300,000 lekë-500,000 lekë, e llogaritur për **16 rastet** me masën minimale të gjobës rezultojnë **vlerën prej 4,800,000 lekë që konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e shtetit**. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” seksioni 2 neni 62-66 “Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit”,

me ligjin nr.10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” nenin 45-48 dhe me ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, neni 29, pika1/ii, “Kundërvajtjet”. Nuk ka njoftim të DR ISHMPU Shkodër nga këto subjekte apo nga DRM Shkodër për marrjen apo jo të lejeve të mjedisit (*Trajtuar në faqen 20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1.Rekomandim:** DR ISHMPU Shkodër për **4 subjektet** e listuara në tabelën e paraqitur në faqen 15-16 të Raportit Përfundimtar të auditimit të marrë masa, që të kërkojë nga subjektet nëpërmjet ri-inspektimit që të paraqesin dokumentacionin ligjor për finalizimin e procesit të licencimit me leje mjedisi.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të procedurave të realizimit të inspektimit të vënë në dispozicion rezultoi në **43 raste** subjektet nuk kanë plotësuar kushtet e lejeve të lëna detyrë, nuk kanë paraqitur raportet e vetmonitorimit periodik (6-mujor) pranë grupit të ri-inspektimit, si dhe ka raste të mosparaqitjes së pagesës së tarifës vjetore për lejet mjedisore. Për këto raste nuk është ndjekur një procedurë e plotë për detyrimin e realizimit nga subjektet të këtyre kushteve, ose në të kundërt vendosjen e masave administrative “dënim me gjobë” në masën 300,000 lekë-500,000 lekë, ku të përlllogaritura për 43 rastet e kundërveprave me masën minimale të gjobës rezultojnë në vlerën prej 12,900,000 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e shtetit.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” seksioni 2 neni 62-66 “Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit”, me ligjin nr.10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” nenin 45-48, me ligjin nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, neni 29, pika1/ii, “Kundërvajtjet”, pika 5, neni 17” Afatet e shqyrtimit” (*Trajtuar në faqen 21-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1.Rekomandim:** DR ISHMPU Shkodër të marrë masa për të programuar dhe ri-inspektuar **43 subjektet** të listuara në tabelën e paraqitur në faqen 16-20 të Raportin Përfundimtar të auditimit, në lidhje me zbatimin e detyrave të lëna në drejtim të zbatimit të kushteve të lejeve, detyrimeve financiare dhe të rishikimit të kushteve të lejeve. Në rast konstatimesh të mosplotësimit të këtyre kritereve mjedisore të ndëshkohen për kundërvajtje ligjore sic parashikon ligji i sipërcituar.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën 2016-2017, janë marrë vendime administrative “gjobë” në **55 raste në vlerën 63,850 mijë lekë**, të ndara për sektorin e Inspektimit të Mjedisit **19 gjoba në vlerën 6,450 mijë lekë** dhe për sektorin e Inspektimit të Pyjeve janë **36 gjoba në vlerën 57,130 mijë lekë**. Nga këto nga ISHMPU Shkodër 31 gjoba janë përcjellë me shkresa në Gjykatën Administrative për kthim në titull ekzekutiv, nga të cilat 2 gjoba janë shfuqizuar nga komisioni i ankimit pranë Inspektoriatit Qendror Tiranë. Ndërsa për 22 gjoba në vlerën 61,150 mijë lekë, janë kthyer përgjigje negative nga Gjykata Administrative në lidhje me shqyrtimin e tyre, me pretendimin se procesverbalet janë të pasakta dhe të paplota, përse i përket të dhënave për adresat e kundërvajtësve. Moskthimi i vendimeve administrative në tituj ekzekutiv përbën shkelje të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” si dhe mos lëshimi i urdhrit të ekzekutimit nga Gjykata Administrative ka sjellë si pasojë pamundësinë e vjeljes së gjobave në vlerën **prej 63,850 mijë lekë, e cila konsiderohet si e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit** (*Trajtuar në faqen 39-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4.1.Rekomandim:** DR ISHMPU Shkodër nëpërmjet sektorëve të Inspektimit dhe juristit, të marrë masa për të mos lejuar mungesa dhe mangësi dokumentacioni dhe provash në praktikat administrative të cilat i përcillen gjykatës për urdhra ekzekutimi, si dhe të ndjekë në vazhdimësi e të rritë praninë në proceset gjyqësore, me qëllim ndjekjen deri në fund të zbatimit të akteve administrative, sidomos ato që kanë të bëjnë me gjoba për vjeljen sa më shpejt të tyre.

*Menjëherë dhe në vazhdimësi*

## C. MASA DISIPLINORE

**C/1.** Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “b” e “ç” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, në ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, si dhe në ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”, nenin 44 “Përgjegjësia e punonjësit të organit administrativ”, **i rekomandoj Kryeinspektorit të ISHMPU-së** Tiranë, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës me status nëpunësit civil fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore nga “**Vërejtje**” deri në “**Largim nga shërbimi civil**”, për punonjësit e mëposhtëm:

### -Sektori i Mjedisit

**1- Për z.E . B** me detyrë, Përgjëgjës i sektorit të Mjedisit , për shkeljet trajtuar në Akt Konstatimi Nr. 1 datë 30.07.2018 “Inspektimi në fushen e mjedisit”.

**2- Për z.N. H** , me detyrë specialist i sektorit të Mjedisit, për shkeljet trajtuar në Akt Konstatimi Nr. 1 datë 30.07.2018 “Inspektimi ne fushen e mjedisit”.

**3- Për z.N.P** me detyrë specialist i sektorit të Mjedisit, për shkeljet trajtuar në Akt Konstatimi Nr. 1 datë 30.07.2018 “Inspektimi ne fushen e mjedisit”.

**C/2.** Mbështetur në Kreu IV, germa “c” dhe “ç” dhe neni 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003, si dhe në kontratën individuale të punës, në ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjit nr, 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” **i kërkojmë Kryeinspektorit ISHMP Tiranë**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe të marrë masë disiplinore nga “**Vërejtje me paralajmërim**” deri në “**ndërrprerje të kontrates së punës**”, për punonjësit e mëposhtëm:

### Sektori i Policisë Pyjore

**1- Për z. N.D.** me detyrë Përgjëgjës i sektorit të Policisë Pyjeve, për shkeljet trajtuar në Akt Konstatimi nr. 2 datë 30.07.2018 “Inspektimi ne fushen e Pyjeve “.

**2- Për z. T. K., me detyre inspektore pyjesh** për shkeljet trajtuar në Akt Konstatimi Nr. 2 datë 30.07.2018 “Inspektimi ne fushen e Pyjeve “.

**3- Për z. A. Ç., me detyre inspektore pyjesh** për shkeljet trajtuar në Akt Konstatimi Nr. 2 datë 30.07.2018 “Inspektimi ne fushen e Pyjeve “.

**4- Për z. P. L. me detyre inspektore pyjesh** për shkeljet trajtuar në Akt Konstatimi Nr. 2 datë 30.07.2018 “Inspektimi ne fushen e Pyjeve”.

**5- Për z. Q. M, me detyre inspektore pyjesh** për shkeljet trajtuar në Akt Konstatimi Nr. 2 datë 30.07.2018 “Inspektimi ne fushen e Pyjeve”.

**6- Për z. F. M, me detyre inspektore pyjesh** për shkeljet trajtuar në Akt Konstatimi Nr. 2 datë 30.07.2018 “Inspektimi ne fushen e Pyjeve”.

**7- Për z. E. E, me detyre inspektore pyjesh** për shkeljet trajtuar në Akt Konstatimi Nr.2 datë 30.07.2018 “Inspektimi ne fushen e Pyjeve “.

**PËR PUNONJËSIN E LARGUAR DHE QË NUK KANË ADRESË INSTITUCIONALE**



Për punonjësit e larguar nga puna *nuk rekomandojmë masë disiplinore, pasi* u janë ndërprerë marrëdhëniet e punës .

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore, do të ishte **“Vërejtje”** deri në **“Ndërprerje të kontrates së punës ”**.

**1- Për z .A R.** me detyrë inspektor pyjesh (për periudhen 06.05.2016-25.01.2018), të cilit i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës, *për shkeljet e trajtuar* në Akt Konstatimi Nr. 2 datë 30.07.2018 “Inspektimi ne fushen e Pyjeve”.

**2- z.F. Z.** me detyrë inspektor (për periudhen 20.12.2017-11.01.2018),”*Për shkeljet trajtuar* në Akt Konstatimi Nr. 2 datë 30.07.2018 “Inspektimi ne fushen e Pyjeve”.

**3- z. D. E.** me detyrë inspektor pyjesh (per periudhen 21.02.2014-03.07.2017), *Për shkeljet e trajtuar* në Akt Konstatimi Nr. 2 datë 30.07.2018 “Inspektimi ne fushen e Pyjeve”.

**4-z. M. N.** me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit (për periudhen 15.02.2016-03.07.2017), *Për shkeljet trajtuar* në Akt Konstatimi Nr. 2 datë 30.07.2018 “Inspektimi ne fushen e Pyjeve”.

**5-z.K. K.** me detyrë inspektore (për periudhen 17.05.2016-19.09.2016); *Për shkeljet trajtuar* në Akt Konstatimi Nr. 2 datë 30.07.2018 “Inspektimi ne fushen e Pyjeve”.

**6- Znj. D. M.** me detyre inspektore pyjesh (për periudhen 17.05.2016-19.09.2016) *Për shkeljet trajtuar* në Akt Konstatimi Nr.2 datë 30.07.2018 “Inspektimi ne fushën e Pyjeve”.

**7- V. Sh.** me detyre ish-Përgjegjës i Sektorit të Pyjeve (për periudhen 21.07.2017-11.01.2018) *për shkeljet trajtuar* në Akt Konstatimi Nr.2 datë 30.07.2018 “Inspektimi ne fushën e Pyjeve.

## **G. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL**

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Inspektori Qendror i Mjedisit Tiranë, konkretisht sektori i Administrimit të burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

**a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr.152/2013 ”Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

**b.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr.152/2013 ”Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, si dhe Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës.

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**